Rod në 171
11.05.2022.

(21)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1038/4 prot. Tiranë, më 06.05.2022

LËNDA: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

INSTITUTI I INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE POLITIKË TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", neni 14/c dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, bashkangjitur ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të

Gjithashtu, bazuar në nenin 12/d, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", "Plani i Veprimit" për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, të miratohet nga titullari i institucionit dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, **jo më vonë se 20 ditë pune** nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit, **sipas formatit të sugjeruar nga ana jonë**.

- Bashkëngjitur, Plani i Veprimit, Formati Standart 10.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI

SKËNDER DRENI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE - TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Për auditimin e kryer në Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë Tiranë

I. Përmbledhje ekzekutive.

Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe e ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të Ligjit Nr. 8246, datë 01.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", i ndryshuar. Kjo qendër financohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet buxhetit të shtetit, për të gjitha zërat e shpenzimeve. Gjatë veprimtarisë institucioni krijon të ardhura nga ndërmarrjet jobuxhetore, këto të ardhura përdoren nga institucioni për të ndihmuar ekonomikisht dhe materialisht, familjet e përndjekura, një pjesë e tyre shkon për financimin e shoqatave të ish të përndjekurve politikë.

Misioni i Institutit të Integrimit të Përndjekurve Politikë Tiranë, është hartimi i programeve dhe zhvillimi i politikave të integrimit të ish të përndjekurve politikë të regjimit komunist. Ky institucion për periudhën 2018 - 2021 ka funksionuar sipas strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 244, datë 1.11.2018 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë". Kjo strukturë ka pësuar ndryshime me Urdhërin e Kryeministrit nr. 162, datë 1.11.2018 "Për disa ndryshime në urdhërin Nr. 244, datë 06.10.2014, të Kryeministrit, "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të Ish – të Përndjekurve Politikë", ku është shkurtuar pozicioni i specialistit të IT, në sektorin e financës dhe shërbimeve. Struktura e IIPP Tiranë, përbëhet nga 23 punonjës.
Ky institucion disponon projekt rregullore të brendshme e përshtatur me strukturën organizative egzistuese të institucionit.

Ky auditim u bazua në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", dhe në planin e punës për vitin 2022, i miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresë nr. 3746/3 prot., datë 11.10.2021, i ndryshuar.

Objektivat e vendosura nga grupi i auditimit lidhur me këtë vlerësim janë;

- Auditimi i sistemeve të identifikuara, nga muaji Janar 2018 deri në muajin Dhjetor 2021, për të vlerësuar saktësinë e regjistrimeve financiare, kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe vlerësimin e kontrolleve të brendshme me objektivat e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Bazuar në programin e auditimit të miratuar nga drejtuesi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 16.03.2022, në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe konkluzionet si më poshtë:

Progresi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit
Nga auditimi rezultoi se rekomandimet e lëna kanë gjetur zbatim duke treguar qëndrim mbështetës ndaj tyre, referencë;

Raporti Përfundimtar dërguar me shkresë nr. 1350/6 prot., datë 02.05.2018. Plani i veprimit, evidentuar 6 rekomandime. **Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 1 të Projekt Raportit.**
Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore
1- Nga vlerësimi i projekt rregullores konstatohet se kjo regullore ka të përfshirë misionin, objektivat, detyrat e përgjegjësve të sektorëve, por kësaj rregullore duhet ti shtohen elemente dhe detyra të tjera. Po kështu, mungojnë detyrat e personelit mbështetës, si arkiv/protokoll, mungojnë gjurma e hyrjes dhe daljes së dokumentave në institucion, mungojnë detyrat e nëpunësit të informacionit, detyrat e shofer/ korrier, sekretar si dhe detyrat e punonjës pastrimi. Për këtë, kjo projekt rregullore duhet të ndryshojë dhe më pas të dërgohet në organin qendror dhe të miratohet nga Ministri i MSHMS-së. **Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 3 të Projekt Raportit.**
Sistemi i Kontabilitetit
1- Gjatë auditimit u konstatua se automjeti që është marrë me qira që nga muaji Maj 2021 furnizohej me karburant me Kartën Gold (tollon elektronik) dhe jo me kartë të personalizuar. 2- Nga inventari kontabël u konstatua se nuk ka një ndarje të mirëfilltë të Aktiveve Afatgjata materiale ndërmjet llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe llogarisë 218 "Inventar ekonomik". **Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 6 të Projekt Raportit.**
Sistemi i prokurimeve me vlerë të vogël
1 - Për periudhën e audituar u konstatua se në 5 raste në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të lartpërmëndura nuk ishte kryer përllogaritja e fondit limit përpara nxjerjes së urdhër prokurimit nga titullari i institucionit (nuk është dokumentuar ky proces në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për prokurimet). 2- Për proceduren e prokurimit "Riparim dhe mirembajtje çatie" në vlerën 119,100 lekë, nuk ka një preventiv që te justifikoje përllogaritjen e fondit limit për kryerjen e punimeve. **Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 4 të Projekt Raportit.**
Sistemi i të ardhurave dytësore
1. Nga auditimi i krijimit të fondit të vecantë, u konstatua se jo të gjithë ndërmarjet shtetërore jobuxhetore kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën prej 1% mbi fondin e pagave. 2. Nga vlerësimi i projekteve të realizuara nga shoqatat, u konstatua se monitorimi i projekteve kryhet kur ka përfunduar i gjithë projekti. Duke qënë që IIPP-ja ka një rol shumë të rëndësishëm në këtë proces, duhen shtuar filtra kontrolli mbi monitorimin e projekteve, c'ka do të thotë që monitorimi i projektit të shtrihet në të gjitha fazat e tij dhe jo vetëm në fund të projektit. gjetja e auditit konsiston te mbikqyrja herë pas here e projektit në tërësi si dhe

dokumentimi i gjithë projektit me cdo dokument justifikues që justifikon shpenzimin e kryer dhe jo të mbetemi vetëm te marrja e faturave me tvsh..

3. Në asnjë rast nuk u konstatua që shoqatat të kenë hartuar një relacion përmbledhës që vënë në dijeni IIPP mbi mbarëvajtjen e projektit, ecurinë e tij, listën e personave përfitues të firmosur prej tyre, certifikatat e pjesmarrjes. Certifikat e pjesëmarrësve sidomos kur ofrohen kurse profesionale medoemos duhet të kërkohen nga ana e grupeve të punës dhe të bëhen pjesë e dosjes, kjo gjë i jep siguri institucionit se fondet e dhëna nga fondi i vecantë përdoren për qëllimin që janë dhënë. Po kështu që në momentin e miratimit të këtyre projekteve duhet ti kushtohet një vëmendje e vecantë edhe përzgjedhjes së subjekteve ku do të kryhet kursi, që këto subjekte të jenë të miratuara nga organet kompetente dhe certifikatat me anë të të cilat pajisen personat të jenë komfort të gjithë akteve ligjore në fuqi.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 7 të Projekt Raportit.

Në përfundim të auditimit për këto sisteme, janë lënë rekomandimet të cilat lidhen me; 1) menaxhimin e burimeve njerëzore; 2) sistemin e kontabilitetit; 3) sistemin e të ardhurave dytësore,4) sistemin e prokurimeve me vlerë të vogël. Rekomandimet janë si më poshtë;

1- Nga ana e institucionit, të bashkëpunohet me përgjegjësit e sektorëve dhe të hartohet rregullorja e re, për cdo pozicion që është i miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 244, datë 1.11.2018 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë. Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm të dërgohet për miratim në organin qendror (MSHMS).

2 - Nga ana e institucionit në vazhdim gjatë hartimit të projekt buxhetit të pasqyrohet në kërkesat buxhetore nevoja për një automjet i cili do i shërbejë institucionit për të përmbushin objektivat e veprimtarisë.

3- Në vazhdimësi nga ana e institucionit për çdo punim të kryer të hartohet paraprakisht një preventiv për llogaritjen e fondit limit si dhe specifikimet teknike me specialistë të fushës për të përcaktuar saktë vlerën e punimeve që do të kryhen.

4- Nga Nëpunësi Autorizues i këtij instiucioni të ndërpritet menjëherë furnizimi i karburantit me Kartën Gold dhe për çdo furnizim të përdoret Karta e Personalizuar.

Dalja e karburantit të bëhet me autorizim nga Nëpunësi Autorizues ku të pasqyrohet arsyeja e lëvizjes së automjetit për harxhimin e karburantit, dhe për çdo rast udhëtimi në bazë të harxhimit të karburantit sipas kilometrave të pritet flete dalja.

Gjithashtu nga sektori i financës në fund të çdo muaji të kryhet rakordimi midis sektorit të financës dhe magazinës dhe ne fund te vitit te kryhet inventari fizik dhe kontabel i karburantit.

5- Nga Nëpunësi Autorizues të meren masa të menjëhershme qe aktivet (kondicionere, tavolina, dollapë etj) të cilat ndodhen në Godinën e Institutit të Integrimit ish të Përndjekurve Politike, të sistemohen në një ambjent të veçantë për t'i mbrojtur ato nga dëmtimi, keqpërdorimi apo humbja e tyre.

6- Nga struktura përgjegjëse për prokurimin ose grupi i punës për çdo prokurim, në vazhdimësi të bëhet përllogaritja e vlerës së fondit limit bazuar në çmimet e tregut dhe në përfundim i gjithë dokumentacioni që lidhet me përllogaritjen e vlerës së kontratës të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

7- Nga shefja e financës se këtij institucioni para mbylljes së bilancit të vitit 2022 të sistemohen veprimet e llogarive 214 dhe 218, shumat të pasqyrohen në bilancin e fundvitit të klasifikuar sipas llogarive përkatëse bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit ekonomik buxhetor", si dhe Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit).

Veprimet rregulluese të jenë pjesë e pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe në relacionin shoqërues të jepen shpjegimet për veprimet e ndërmara nga struktura përgjegjëse për financën (Nëpunësi Zbatues).

8- Nga ana e institucionit ti kushtohet rëndësi monitorimit të projekteve, i cili duhet të shtrihet në të gjitha fazat e tij dhe jo vetëm në fund të projektit. Dosja e monitorimit të ketë gjithë dokumentacionin e nevojshëm si; listën e pjesmarrësve në trajnim, axhendën e trajnimit, vendin ku kryhet trajnimi, kopje të certifikatave të trajnimit për cdo pjesëmarrës, me qëllim dhënien e sigurisë te titullari, që përdorimi i fondeve të dhëna nga fondi i vecantë janë përdorur me eficencë, efektivitet dhe ekonomi.

9- Nga ana e institucionit të ndiqet në vazhdimësi procesi i mbledhjes së të ardhurave nga ndërmarrjet jobuxhetore si pasojë e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", neni 1, shkronja b.

II. Hyrje.

Bazuar në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"; Manualin e Auditimit të Brendshëm, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 dhe Planit Vjetor 2022, miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 3746/3 prot., datë 11.10.2021; grupi i auditimit sipas Programit të Angazhimit të Auditimit miratuar me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 16.03.2022, kreu auditimin për të gjitha sistemet e përfshira në program angazhimin e auditimit. Sistemi i kontabilitetit; përputhshmëria e zbatimit të buxhetit, sistemi i prokurimeve me vlerë të vogël; sistemin e pagesave, sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe sistemi i kontrollit të brendshëm, zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit. Në institucion u njohëm me raportin përfundimtar të dërguar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MSHMS me shkresën nr. 1350/6 prot., datë 02.05.2018, është audituar periudha 10 Korrik 2014 deri më 31 Dhjetor 2017 për të gjitha sistemet. Për këtë grupi i auditit verifikoi dhe auditoi periudhën Janar 2018 - Dhjetor 2021.

Baza ligjore ku është mbështetur auditimi;

- Ligji Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".
- Manuali për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit te Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 8, datë 09..03.2018 "Për Procedurat e Pregatitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e qeverisjes se pergjithshme".
- Udhezimi nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- Udhëzimi plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018".
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuar.
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për Përcaktimin e Standardeve dhe të Rregullave Kontabël".

- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- Ligj Nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", i ndryshuar.
- Të ndryshme: Udhëzime, Udhëzues, Urdhëresa dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të ligjeve, vendimeve, urdhërave në fuqi.

Periudha e auditimit: Janar 2018 deri më Dhjetor 2021

Afati i auditimit: 08.03.2022 – 1.04.2022

Grupi i auditimit:

1. Sonila Rreshka, përgjegjëse grupi
2. Zogulla Koto, specialiste auditi

Para fillimit të angazhimit të auditimit, u zhvillua takimi prezantues në datë 08.03.2021, në të cilën morën pjesë përfaqësues të institucionit dhe grupi i auditimit. Përgjegjësi i grupit të auditit me anë të postës elektronike ëëë.shendetesia.gov.al më datë 04.03.2022 lajmëroi institucionin për fillimin e auditimit.

Njoftimi për fillimin e auditimit institucionit i ka shkuar edhe me shkresë zyrtare. Është kërkuar nga institucioni informacioni paraprak mbi të cilin është bërë edhe vlerësimi i risqeve për cdo sistem sipas formateve, 4, 5 dhe 8, institucioni ka kthyer përgjigje me e-mail. Në datën 16.03.2022, përgjegjësi i grupit ka vënë në dijeni Drejtuesin e Auditimit të Brendshëm mbi shtyrjen e afatit të auditimit, kjo kërkesë është marrë në konsideratë dhe është lajmëruar IIPP në adresën zyrtare për shtyrjen e afatit të auditimit nga data 26.03.2022 deri më datë 01.04.2022.

Qëllimi i misionit të auditimit është vlerësimi i saktësisë së regjistrimeve financiare, kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe vlerësimin e kontrolleve të brendshme për periudhën e audituar.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra u hartua Projekt Raport Auditimi, i cili u dërgua në Institutin e Integrimit të Përndjekurve Politikë Tiranë me shkresën përcjellëse me nr. 1038/2 prot, datë 19.04.2022. Institucioni ka dërguar shkresë përcjellëse me nr. 156 prot, datë 04.05.2022, një kopje e Projekt Raportit nuk është dërguar pasi, institucionit nuk i ka shkuar projekt Raporti i auditimit me postë, për shkak të problemeve që ka pasur posta. Projekt Raporti është marrë një kopje në protokollin e MSHMS-së. Në shkresën përcjellëse dërguar edhe në adresën e e-mailit na bëhet me dije se institucioni i pranon të gjitha rekomandimet e lëna nga auditi.

III. Metoda e Auditimit.

Puna e grupit të auditimit u mbështet në Programin e Angazhimit të Auditimit, miratuar me shkresën nr. 1308/1 prot., datë 16.03.2022, si dhe me objektivat e vendosura për këtë auditim.

Ky institucion auditohet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MSHMS. Nga ana e institucionit u vunë në dispozicion dokumentet kryesore, si; situacionet e realizimit të buxhetit, evidencat e të ardhurave dytësore, lidhjet e bankës (për likuidimet e shpenzimeve), struktura analitike, pasqyrat financiare, rregullorja e brendshme etj., me të cilat u njoh grupi i auditimit gjatë punës në terren. Referuar dokumenteve kryesore u bë dhe përzgjedhja e kampionëve për auditim, për të cilën më konkretisht jemi shprehur në pikën IV, të Projekt Raportit "Gjetjet dhe konkluzionet". Grupi i

auditimit bazuar në sistemet e identifikuara plotësoi formatet standarte për vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe të risqeve për çdo sistem, kreu investigimin paraprak dhe në fund përgatiti programin e auditimit.

Gjatë punës në terren u zhvilluan intervista me stafin e institucionit për të kuptuar më mirë ndarjen e detyrave, përcjelljen e dokumentacionit nga njëra strukturë tek tjetra, njohjen e dispozitave ligjore nga ana e stafit, si dhe mënyrën e vendosjes së kontrolleve në proceset e prokurimit apo të menaxhimit të aktiveve dhe burimeve njerëzore.

Metoda e kryerjes së këtij auditimi është metoda me përzgjedhje. Përveç metodës bazë u përdor metoda hap pas hapi, pra duke ndjekur procedurat e përcaktuara për auditimin e sistemeve nga fillimi në fund; metoda e ndjekjes së dokumentacionit, metoda e ekzaminimit kryq, për të vlerësuar nëse kontrollet e brendshme po funksionojnë për përmbushjen e objektivave dhe me kosto efektive dhe në mënyrë eficente, si dhe rakordimi i të dhënave nga burime të ndryshme.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet.

Pas auditimit të të gjithë sistemeve të përcaktuara në programin e auditimit, grupi i auditimit jep vlerësimet e mëposhtme:

IV.1 Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit.

Auditimi i fundit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë Tiranë. Auditimi është kryer në zbatim të programit të auditimit miratuar me shkresën nr. 1350/2 prot., datë 07.03.2018. Në institucion u njohëm me raportin përfundimtar të dërguar nga DAB në MSHMS me shkresën nr. 1350/6 prot., datë 02.05.2018, është audituar që nga Korrik 2014 deri më 31 Dhjetor 2017 për të gjitha sistemet.

Në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar janë lënë 6 (gjashtë) rekomandime.

Titulli i gjetjes: Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Gjetje Nr. 1	
Subjekti i audituar	Instituti i Integrimit të Përndjekurve Politikë Tiranë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Sektori i Financës dhe Shërbimeve
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik". Manuali për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit te Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" Kap. 4.1.13.

Përshkrimi i gjetjes **Përshkrimi i gjetjes**	**Situata:** Në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kap. 4.1.13 procesi i auditimit filloi me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, raport i dërguar në Auditimi i fundit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë Tiranë, është kryer në zbatim të programit të auditimit miratuar me shkresën nr. 1350/2 prot., datë 07.03.2018. Raporti përfundimtar është dërguar me shkresën nr. 1350/6 prot., datë 02.05.2018. Periudha e audituar që nga Korrik 2014 deri më 31 Dhjetor 2017 për të gjitha sistemet. Nga ana e institucionit është dërguar plani i veprimit me shkresën nr. 398 prot., datë 31.05.2018. Në raportin përfundimtar të auditimit janë lënë 6 (gjashtë) rekomandime. Nga verifikimi i rekomandimeve të lëna u konstatua se rekomandimet kanë gjetur zbatim, duke treguar qëndrim mbështetës ndaj rekomandimeve.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I ulët
Konkluzioni	Institucioni i ka kushtuar rëndësinë e duhur dhe ka vlerësuar me përgjegjshmëri rekomandimet e lëna nga auditimi.
Rekomandimi	S'ka
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Si përfundim, vlerësojmë se nga institucioni janë marë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit.

IV.2. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit

Përputhshmëria e zbatimit të buxhetit.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse buxheti është menaxhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë efektive e efiçente.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Vlerësimi paraprak i lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura. Klasifikimi i tyre sipas standarteve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të detyrimeve për çdo katekori.
- Evidentimi dhe rakordimi i të dhënave për kontratat, urdhërat e gjykatës apo zyrave të përmbarimit gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve të formës prerë, të mbetura të papaguiara 30 ditë pas datës së përcaktuar në kontrat apo ligj.
- Verifikimi i rregjistrit të prokurimeve për fondet publike, mallra shërbime, punë publike të depozituar pranë Degës së Thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe ndaj çdo rishikimi të tij gjatë vitit ushtrimor.

- Auditimi i disponibilitetit të fondeve buxhetore për financimin e zbatimit të projekteve të ndryshme, të investimeve, apo shërbimeve në vitin ushtrimor dhe atyre që zgjasin në vitet në vazhdim, përpara se të fillojë procedura e prokurimit publik.
- Auditimi i regjistrimit, evidentimit në kontabilitet, si dhe Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) të Degës së Thesarit të detyrimeve të prapambetura dhe të shtesave të kontratave. Verifikimi i dokumentacionit mbështetës dhe procedurave për përfshirjen e detyrimeve financiare në listën e shlyerjes së tyre.
- Verifikimi i respektimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për secilin kategori, sipas parimit të radhës kohore të krijimit të detyrimit financiar dhe sipas sektorëve.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit.

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse monitorimi i zbatimit të buxheti është menaxhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në menyrë efektive e efiçente.

- Hartimi i planit shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin korrent, dhe për periudhën afatmesëm. Përgatitja e planit të masave që parashikohet të ndërmirren për parandalimin e krijimit të detyrimeve në të ardhmen.
- Verifikimi i raportimit periodik të monitorimit të performancës së buxhetit, nga njesitë e qeverisjes qendrore, si dhe përgatitja e informacionit analitik mbi ecurinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

Për periudhën objekt auditimi, referuar pasqyrave financiare (bilanceve) të këtij institucioni, nuk rezultonin debitore (të drejta për tu arkëtuar).

Llogaritë e detyrimeve (klasa 4) "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqiten si më poshtë:

Emeritimi i llogarisë	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Llog. 401 "Furnitorë e llogari të lidhura"	60,457	27,412	33,366	45,735
Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	1,137,624	1,285,102	1,351,308	1,489,028
Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit tatim taksa"	84,373	93,409	132,198	127,285
Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	180,652	203,450	213,627	202,092
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	21,046	23,434	24,654	22,990
Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	11,402,941	7,730,743	3,469,103	461,103

Në pasiv të bilancit në llogaritë e klasës 4 janë pasqyruar detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin (llog 401-408), detyrime për pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore e shëndetësore (llog 421, 435, 436) dhe detyrime ndaj shtetit për tatim taksa (llog. 431) të muajit Dhjetor të çdo viti të cilat janë likujduar në muajin Janar të vitit pasardhës. Në fund të vitit 2021 llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" rezulton në vlerën 461,103 lekë, detyrim i cili është likujduar në muajin Mars të vitit 2022. Theksojmë se këto detyrime kanë lindur që nga viti 1998, 2000, 2005, 2006, 2008 dhe 2013 dhe konkretisht përfaqësojnë;

-Detyrime referuar objektit të padisë si pasojë e mos ekzekutimit të kontratës së shërbimit, shpenzime gjyqësore dhe tarifa përmbarimore, dmth për kontrata shërbimi për banesa që shpërndante institucioni.

-Mos pagesa të detyrimeve ndaj kompanive të telefonisë celulare lidhur me telefonat me kontratë për punonjësit e institucionit për të cilat gjykata ka vendosur me vendim të formës së prerë që këto detyrime të paguhen nga institucioni.

-Largime nga puna të punonjësve të cilët kanë fituar proceset gjyqësore.

Blerje pajisje kompjuterike në vlerën 1,099,671 lekë, prokurim ky i kryer nga AKSH-I në vitin 2018. Ky detyrim nuk është likujduar nga institucioni brenda këtij viti për arsye se janë shkurtuar fondet, bazuar në Aktin normativ nr.1, datë 26.07.2018, vlerë kjo e likujduar në vitin 2020.

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Mjedisi i kontrollit të brendshëm për këtë sistem nuk ka funksionuar mirë në drejtim të ndjekjes sistematike dhe shlyerjes së detyrimeve te lindura gjate cdo viti ushtrimor. Referuar bilancit të vitit 2021 rezulton se detyrimet e pa likujduara nga ky institucion në fund të vitit përfaqësohen në vlerën 461,103 lekë, vlerë e cila është likujduar në muajin Mars të vitit 2022 (Urdhër Shpenzimi nr. 49, datë 10.03.2022). Zyra e financës ka pasqyruar saktë të drejtat dhe detyrimet sipas llogarive kontabel në mbyllje të pasqyrave financiare. Të drejtat për tu arkëtuar debitoret, (llogaria 423-429), personeli, paradhënje, defiçite dhe gjoba, rezultojnë në vlerën zero.

IV.3 Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore.

Objektivi i auditimit:
Vlerësimi nëse burimet njerëzore menaxhohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me strukturen organizative të miratuar.

Fushat që do të merren në konsiderate gjatë auditimit:
- Respektimi i numrit të punonjësve në total dhe sipas emërtimeve për çdo sektor e shërbim me strukturën organizative të miratuar.
- Respektimi i procedurave për emërimet e reja si dhe largimet në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Programi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- Përllogaritja e nivelit të pagës në përputhje me emërtesën në strukturë dhe me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Për respektimin e numrit të punonjësve ky institucion është bazuar në strukturën analitike miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 244, datë 1.11.2018 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë". Kjo strukturë ka pësuar ndryshime me Urdhërin e Kryeministrit nr. 162, datë 1.11.2018 "Për disa ndryshime në urdhërin Nr. 244, datë 06.10.2014, të Kryeministrit, "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të Ish – të Përndjekurve Politikë", ku është shkurtuar pozicioni i specialistit të IT, në sektorin e financës dhe shërbimeve.

Struktura e IIPP Tiranë, përbëhet nga 23 punonjës në total:

- Drejtori i përgjithshëm
- Sekretar
- 1 Përgjegjës sektori i ligjshmërisë dhe statusit dhe 2 specialist
- 1 Përgjegjës sektori i gjetjes së të zhdukurve nga krimet e komunizmit dhe 2 specialistë
- 1 Përgjegjës sektori i financës dhe shërbimeve, në këtë sektor janë specialist finance, 1 arkivist, nëpunës informacioni, shofer/korrier, 1 punonjës pastrimi.

Ky institucion është pjesë e shërbimit civil dhe marrëdhënia e punës për të gjithë punonjësit është e rregulluar nga Departamenti i Administratës Publike. Emërimet dhe largimet në këtë institucion, kryheshin nëpërmjet procedurave të konkurimit të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike. Përgjatë periudhës 2018 – 2021 që është edhe periudha e audituar, ka patur largime bazuar në periudhën e përcaktuar nga ligjet në fuqi për vitet e punës, dalje ne pension pleqerie si dhe një specialist pas dy vlerësimesh negative. Në mars 2019 katër pozicione që ishin vakantë janë plotësuar me studentët e ekselencës dhe konkretisht pozicionet janë;

1. Specialist, Sektori i Ceshtjeve Sociale dhe Kordinimit te Projekteve
2. Specialist, Sektori i Ceshtjeve Sociale dhe Kordinimit te Projekteve
3. Specialist, Sektori i Ligjshmerise dhe Statusit
4. Specialist, Sektori i Ligjshmerise dhe Statusit

Në vitin 2020 të katër pozicionet janë plotësuar me studentët e ekselencës, me konkurs të zhvilluar nga Deparatamenti i Administratës Publike dhe janë emëruar nëpunës civil në periudhë prove derisa në vitin 2021 kanë marë statusin e nëpunësit civil. Në Gusht të vitit 2020 pozicioni vakant në sektorin e financës është plotësuar me lëvizje paralele nga brenda stafit po me procedurë nga DAP-i. Dosjet e personelit ishin të inventarizuara dhe cdo dosje ishte e plotësuar me dokumentacionin përkatës.

Nga ana e institucionit për periudhën e audituar janë kryer vlerësimet vjetore të performancës për gjithë personelin, dhe janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion si janë të përcaktuar në strukturën e institucionit.

Nga ana e organit qendror (MSHMS) ishte instaluar sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMIS) dhe ishte funksional. Ky sistem ishte i plotësuar me të gjitha të dhënat e nevojshme për gjithë stafin e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë. Në këtë sistem cdo punonjës kishte dosjen e plotë që nga urdhëri i emërimit, pozicionin, dokumentat personale si dhe pagën. Ky proces mbikqyrej vazhdimisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Implementimi i këtij programi dhe dokumentimi i saktë i këtij procesi nga sektori i financës dhe shërbimeve është në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.44, datë 28.01.2019 "Për hedhjen e të dhënave në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe raportimin në kohë reale të ndryshimeve në strukturë dhe personel", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën, administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Për verifikimin e sistemit të pagave na u vendosën në dispozicion borderotë e pagave për të gjitha vitet objekt auditimi. Bazuar në teknikat e auditimit u përzgjodhën në mënyrë rastësore mbi 25 % të borderove të pagave për të gjitha vitet objekt auditimi për të verifikuar elementet e pagës bruto të cilat janë; paga e grupit, shtesat për pozicion, shtesat për vjetërsi si dhe analiza e pagës për punonjësit mbështetës. U bë analiza e elementëve përbërës të pagës për secilin sektor dhe pozicion pune. Pagat e llogaritura u krahasuan me strukturën analitike të miratuar nga Kryeministria në përputhje me Vendimet e Këshillit të Ministrave për pagat, përkatësisht, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 187, datë 08.03.2017 "Për Miratimin e Strukturës dhe Nivelit të Pagave të Nëpunësve/civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrisë së linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit Qëndror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të nministrave të linjës dhe administratën e prefektit".

Rezulton se numri i punonjësve të paguar me bordero është i njëjtë dhe nuk ka lëvizje të punonjësve. Për vitin 2019 u përzgjodhën, borderoja e muajit Prill, Maj dhe Tetor, ndërsa për vitin 2021 u përzgjodhën, borderoja e muajit Tetor, Nëntor dhe Dhjetor. Nga auditimi i kryer rezultoi se është respektuar numri i punonjësve në total sipas strukturës dhe në mënyrë analitike, sipas çdo sektori dhe shërbimi. Përmbledhëset e pagave ishin të firmosura si nga shefja e financës dhe titullari i institucionit dhe nga thesari, ndalesat për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi pagë përputheshin me likujdimet e bëra me urdhër shpenzimet. Borderot ishin të kuadruara dhe për muaj të veçantë u bë verifikimi me ditarin e bankës me përmbledhësen e borderos dhe nuk pati gjetje për llogaritjet nga ana matematikore. Cdo bordero ishte e shoqëruar me listë prezencën e cila ishte e vecantë për të gjithë sektorët, këto listë prezenca firmoseshin nga përgjegjësi i sektorit dhe sektori i financës dhe shërbimeve. Për periudhën e audituar nga ana e sektorit të financave listë pagesat janë hartuar të ndara në sektorë sipas strukturës analitike të miratuar nga Kryeministri.

Titulli i gjetjes: Ndryshimi i projekt rregullores dhe dërgimi për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjetje Nr. 1	
Subjekti i audituar	Instituti i Integrimit të Përndjekurve Politikë Tiranë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse Sektori i Ligjshmërisë dhe Statusit Sektori i Gjetjes së të Zhdukurve Sektori i Cështjeve Sociale & Koordinimit të Projekteve
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 90/2012 Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore".
Përshkrimi i gjetjes	**Situata;** Nga auditimi i projekt rregullores së brendshme, u konstatua se kjo projekt rregullore është hartuar që në vitin 2015, nga përgjegjësi i sektorit të ligjshmërisë dhe statusit. Me anë të shkresës nr. 5/1 prot, datë 07.01.2015, kjo projekt rregullore është dërguar në Ministrinë e Mirëqënies dhe Mbrojtjes Sociale me nr.

	5 prot., datë 07.01.2015. Nga ana e kësaj ministrie nuk ka pasur asnjë përgjigje. Nga vlerësimi i projekt rregullores konstatohet se kjo regullore ka të përfshirë misionin, objektivat, detyrat e përgjegjësve të sektorëve, por kësaj rregullore duhet ti shtohen elemente dhe detyra të tjera. Po kështu, mungojnë detyrat e personelit mbështetës, si arkiv/protokoll, mungojnë gjurma e hyrjes dhe daljes së dokumentave në institucion, mungojnë detyrat e nëpunësit të informacionit, detyrat e shofer/ korrier, sekretar si dhe detyrat e punonjës pastrimi. Për këtë, kjo projekt rregullore duhet të ndryshojë dhe më pas të dërgohet në organin qendror dhe të miratohet nga Ministri i MSHMS, në zbatim të Ligjit nr. 90/2012 "Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", neni 29, rregulloret e brendshme, pika 2 citon se - Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij. **Kriteri**: Baza ligjore që është bazuar gjetja është Ligji Nr. 90/2012 "Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", neni 29, pika 2. **Ndikimi/Efekti:** Punonjësit edhe pse kanë përshkrime pune sërish përcaktimi i detyrave që duhet të ndjekin duhet të jenë të mirëpërcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit. **Shkaku;** Hartimi i një projekt rregullore jo sipas pozicioneve që janë të përcaktuara në strukturën e institucionit, por janë përcaktuar detyra sipas sektorëve dhe përgjegjësve të sektorëve.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Ky institucion është pjesë e shërbimit civil dhe marrëdhënia e punës për punonjësit është e rregulluar nga Departamenti i Administratës Publike. Emërimet dhe largimet e punonjësve bëhen nëpërmjet DAP. Nga ana e sektorit të financës dhe shërbime mbështetëse njihet baza ligjore për sistemin e burimeve njerëzore, dhe administrohet sistemi i burimeve njerëzore HMIRS.
Rekomandimi	Nga ana e institucionit, të bashkëpunohet me përgjegjësit e sektorëve dhe të hartohet rregullorja e re, për cdo pozicion që është i miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 244, datë 1.11.2018 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë. Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm të dërgohet për miratim në organin qendror (MSHMS).
Afati i fundit për zbatimin e	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*

rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Opinioni i përgjithshëm: Nga ana e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse bëhet një punë e mirë në procesin e administrimit të dokumentave të personelit dhe të ruajtjes së të dhënave dhe hedhjes së tyre në programin HRMIS. Në këtë sistem cdo punonjës kishte dosjen e plotë që nga urdhëri i emërimit, pozicionin, dokumentat personale si dhe pagën. Ndryshimet duhet të ndodhin në projekt rregulloren e brendshme e cila duhet të rihartohet dhe të përshtatet sipas pozicioneve të strukturës.

IV.4 Sistemi i prokurimeve me vlerë të vogël.

Fushat të cilat u morën në konsideratë gjatë auditimit:

- Hartimi i regjistrit të parashikimit dhe raportimi i realizimit të tyre sipas kërkesave të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi për prokurimet.
- Respektimi i procedurave të prokurimeve që nga përzgjedhja e procedurës e deri në lidhjen e kontratës.

Për periudhën objekt auditimi Janar 2018 – Dhjetor 2021 në Institutin e Integrimit të ish të Përndjekurve Politike janë kryer prokurime me vlerë të vogël vetëm nga buxheti i shtetit. Bazuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, regjistrin e realizimit të prokurimeve, ditarin e bankës, dhe sistemin elektronik të prokurimeve, për periudhën objekt auditimi u përzgjodhën mbi 25% të procedurave për auditim. Nga të gjitha procedurat e prokurimeve vetëm një prej tyre ishte për investime të kryera në vitin 2018 për blerje paisje informatike që ishte kryer si prokurim nga AKSH–i, ndërsa pjesa tjetër përfaqësonin shpenzime korrente për prokurime me vlerë të vogël. Të gjitha procedurat e prokurimeve ishin realizuar nga buxheti i shtetit.

Për periudhën e audituar u përzgjodhën 12 procedura si më poshtë:

- Mirëmbajtje automjeti, vlera e kontratës 453,600 lekë, realizuar në vitin 2018.
- Siguracion automjeti, nën vlerën 19,764 lekë, realizuar në vitin 2018.
- Blerje detergjentë, vlera e kontratës 115,860 lekë, realizuar në vitin 2018.
- Blerje tonera dhe kancelari, vlera e kontratës 680,400 lekë, realizuar në vitin 2019.
- Mirëmbajtje pajisje zyre, 116,200 lekë, realizuar në vitin 2019.
- Mirëmbajtje catie, mirëmbajtje 119,100 lekë, realizuar në vitin 2019.
- Blerje materiale kancelari, vlera e kontratës 588,000 lekë, realizuar në vitin 2020.
- Mirëmbajtje pajisje zyre vlera e kontratës 107,500 lekë, realizuar në vitin 2020.
- Shpenzime zhvendosje zyrash në vlerën 117,600 lekë, realizuar në viti 2020.
- Marrje automjeti me qira, vlera e kontratës 936.00 lekë, realizuar në vitin 2021.
- Blerje karburanti në vlerë 670,500 lekë realizuar në vitin 2021.
- Likujdim interneti nën vlerë 100,000 lekë realizuar në vitin 2021.

Titulli i gjetjes: Përllogaritja e fondit limit.

Nr. i Gjetjes 1

Subjekti i audituar	Komisioni i blerjeve të vogla
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues Komisioni i blerjeve të vogla
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", neni 28, i shfuqizuar me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 9, llogaritja e vlerës së kontratës, neni 59, përllogaritja e vlerës limit të kontratës, i shfuqizuar me Vendimin e Këshillit të Ministave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** -Blerje tonera dhe kanceleri, në vlerën 680,400 lekë, realizuar në vitin 2019. -Mirembajtje pajisje zyre, në vlerën 116,200 lekë, realizuar në vitin 2019. -Mirembajtje pajisje zyre, në vlerën 107,500 lekë, realizuar në vitin 2020. -Shpenzime zhvendosje zyrash në vlerën 117,600 lekë, realizuar në viti 2020 -Likujdim interneti në vlerën 6,000 leke në muaj, realizuar në vitin 2021 Për periudhën e audituar u konstatua se në 5 raste në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të lartpërmëndura nuk ishte kryer përllogaritja e fondit limit përpara nxjerjes së urdhër prokurimit nga titullari i institucionit (nuk është dokumentuar ky proces në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për prokurimet). **Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", neni 28, i shfuqizuar me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 9, llogaritja e vlerës së kontratës, neni 59, përllogaritja e vlerës limit të kontratës, i shfuqizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrve nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"; **Ndikimi/Efekti:** Mungesa e përllogaritjes së fondit limit çon në një planifikim jo të saktë të buxhetit dhe ndikon në përdorimin

	me ekonomicitet, dhe eficence të fondeve buxhetore. **Shkaku:** Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në fushën e prokurimeve.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël është me përvojë në fushën e prokurimeve dhe është e pajustifikueshme që përllogaritja e fondit limit të mungojë në procedurat e prokurimit si një nga hapat më thelbësore për realizimin e një procedure te tille në përshtajtje të nevojave të autoritetit kontraktor.
Rekomandimi	Nga struktura përgjegjëse për prokurimin ose grupi i punës për çdo prokurim, në vazhdimësi të bëhet përllogaritja e vlerës së fondit limit bazuar në çmimet e tregut dhe në përfundim i gjithë dokumentacioni që lidhet me përllogaritjen e vlerës së kontratës të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Titulli i gjetjes: Në vazhdim për prokurimet me vlerë të vogël.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Komisioni i blerjeve të vogla
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues Komisioni i blerjeve të vogla
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i shfuqizuar me Ligjin Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". VKM nr. 914 , datë 29.12.2014, i ndryshuar, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i shfuqizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. VKM nr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre".
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Urdhër shpenzimi me nr. 271, datë 10.12.2019 me objekt; Riparim dhe mirëmbajtje çatie në vlerën 119,100 lekë. Prokuruar me vlerë të vogël nr. 7, datë 18.11.2019 me përshkrim: "Cati vendi e zakonshme" 20 m² dhe "Tavan me kartonxhes 2.297/a", 6 m² në vlerë 119,100 lekë.

	Kjo procedurë është kryer me prokurim nën vlerën 100,000 lekë. Lidhur me procedurën e mësipërme nuk ka një preventiv që të justifikojë përllogaritjen e fondit limit për kryerjen e punimeve për riparimin e çatisë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i shfuqizuar, neni 9, llogaritja e vlerës së kontratës. Pra, nuk ka një preventiv që të argumentoje kryerjen e këtyre punimeve si dhe mungojnë specifikimet teknike për materialin e kartonxhesit të përdorur për tavanin. Gjithashtu për këtë procedurë mungon dhe situacioni i punimeve të realizuara nga firma dhe i cili duhet ti bashkangjitet faturës tatimore të shitjes për likujdim. Gjatë auditimit u konstatua se sipas procesverbalit nr. 802 prot., datë 22.11.2019, komisioni i marjes në dorëzim përbëhej nga: Kryetar, punonjës informacioni Anëtar, sanitare Anëtar, shofer. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik", i ndryshuar, pika 42 dhe 43. Pra, komisioni i marjes në dorëzim ngritur me urdhër të titullarit duhet të jetë me specialistë të fushës dhe jo me punonjës të sektorit mbështetës. Në çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të gjithë procedurën e marrjes në dorëzim të riparimeve që janë kryer. **Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", neni 28, i shfuqizuar me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 9, llogaritja e vlerës së kontratës, neni 59, përllogaritja e vlerës limit të kontratës, i shfuqizuar me Vendimin e Këshillit të Ministave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"; Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar. **Ndikimi/Efekti:** Grupi i punës nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur përllogaritjes së fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike referuar objektit të prokurimit. **Shkaku:** Mos interpetimi i duhur i bazës ligjore.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël për këtë procedurë, para

	se të nxirej urdhër prokurimi nga drejtuesi i institucionit duhet të hartonte një preventiv për llogaritjen e vlerës si dhe pregatitjen e specifikimeve teknike.
Rekomandimi	Në vazhdimësi nga ana e institucionit për çdo punim të kryer të hartohet paraprakisht një preventiv për llogaritjen e fondit limit si dhe specifikimet teknike me specialistë të fushës për të përcaktuar saktë vlerën e punimeve që do të kryhen.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:

Si përfundim theksojmë, se lidhur me procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël nga ana e institucionit përgjithësisht është punuar mirë, me përjashtim të rasteve të trajtuara në gjetjet e mësipërme, ku nuk janë respektuar të gjitha procedurat ligjore. Përllogaritja e fondit limit përpara nxjerjes së urdhërit të prokurimit nga drejtuesi i institucionit, si dhe dokumentimi i shërbimeve të kryera nga ana e komisionit me proces verbalin përkatës. Nuk ka funksionuar mirë kontrolli i brendshëm në procedurat e prokurimit konkretisht per riparimin e çatise se këtij institucioni ku pavarësisht vlerës së vogël, nga grupi punës duhet të ishte haruar një preventiv si dhe situacioni nga subjeki që ka kryer riparimin.

Në përfundim vlerësojmë se strukturat të cilat përfshihen në procedurat e prokurimit të përditësohen me aktet ligjore në fushën e prokurimeve si dhe të kryejnë trajnime për të shmangur në të ardhmen kryerjen e veprimeve në kundërshtim me këto akte.

IV.5 Sistemi i pagesave.

Fushat të cilat u morën në konsideratë gjatë auditimit:

- Kryerja e pagesave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, verifikimi i dokumentacionit justifikues.
- Regjistrimi i transaksioneve të kryera në ditarin e bankës për emërtesën, vlerën dhe llogarinë kontabël.

Titulli i gjetjes; Sistemi i pagesave

Gjetje Nr.1	
Subjekti i audituar	Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore (i ndryshuar); Udhëzim Nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Për auditimin e sistemit të pagesave nga institucioni na u vendos në dispozicion ditari i bankës, lidhjet e bankës si dhe situacione e shpenzimeve për periudhën 2018 – Dhjetor 2021. Bazuar në periudhën objekt auditimi, kampionët që u përzgjodhën për auditim janë borderotë e përzgjedhura si më poshtë: Për vitin 2019 u përzgjodhën, borderoja e muajit Prill, Maj dhe Tetor, ndërsa për vitin 2021 u përzgjodhën, borderoja e muajit Gusht, Nëntor dhe Dhjetor. Nga verifikimi i lidhjeve të bankës të përzgjedhura për auditim u konstatua se rregjistrimi dhe kontabilizimi i veprimeve është kryer i rregullt në ditar, shuma e likujdimeve të urdhër - shpenzimeve është e njëjtë me shumën e pasqyruar në ditarin e bankës. Të gjitha urdhër–shpenzimet, firmoseshin nga drejtori i përgjithshëm, përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse dhe nëpunësi i thesarit, duke respektuar në këtë mënyrë rregullin e firmës së dyfishtë. Rregjistrimet kontabël bëhen në mënyrë manuale, dhe në exel por pa program finance. Ditarët e bankës për cdo vit printoheshin nga përgjegjësi i zyrës së financës, firmoseshin dhe bëheshin pjesë e dokumentave të sistemit të pagesave bashkë me lidhjet e bankës. Në këtë mënyrë sigurohet ruajtja e të dhënave kontable në rast të ndonjë problemi që mund të shkaktohet nga kompjuterat. Të gjithë urdhër shpenzimet që kryheshin kishin të bashkëngjitur dokumentacionin justifikues si fletë hyrjen, faturën tatimore me tvsh të subjektit që dorëzonte mallin, procesverbalin e kolaudimit dhe shuma e faturave tatimore, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit (në ato raste kur kishte procedura prokurimi) si dhe fletë hyrjet, përputheshin me likujdimet që ishin kryer nga ky institucion nëpërmjet llogarive bankare. Regjistrimi i veprimeve kontabël në ditarin e bankës janë kryer sipas planit kontabël dhe udhëzimeve përkatëse. Veprimet e kryera në llogaritë bankare janë të regjistruara me nr rendor, në mënyrë kronologjike me dokumentacionin justifikues, vërtetues dhe autorizues, te bashkangjitur. Kontabilizimi në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve është në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare sipas planit të ri kontabël. Shumat e mbledhura të cdo muaj mbarten në muajin tjetër duke mbledhur dhe kuadruar muajin dhe progresivin në vazhdimësi në debi e kredi. Situacioni i shpenzimeve ishte i kuadruar për cdo muaj dhe i firmosur me vulë thesari. Pjesën më të madhe të buxhetit e zënë pagat dhe shtesat mbi pagat dhe sigurimet shoqërore. Nga ana e sektorit të financës kryheshin shpenzime nga të ardhurat e krijuara nga fondi i vecantë (art 604), 50% e fondit shkonte për financimin e projekteve për shoqatat e ish të përndjekurve politikë, 50% e fondit të vecantë shkonte për

	familjet e përndjekura si ndihmë ekonomike dhe materiale. Nga auditimi i dhënies së këtij fondi të vecantë u konstatua se projektet miratoheshin me vendim nga komisioni i administrimit të ndihmave ekonomike mbas shqyrtimit të kërkesave të individëve dhe mbas shqyrtimit të projekteve të sjella nga shoqatat. Më pas me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dërguar sektorit të financës dhe shërbimeve dhe sektorit të cështjeve sociale urdhërohej zbatimi i vendimit të komisionit. Edhe në këto raste urdhër shpenzimet ishin të firmosura nga drejtori i përgjithshëm, përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse dhe nëpunësi i thesarit, duke respektuar në këtë mënyrë rregullin e firmës së dyfishtë. **Kriteri:** Baza ligjore ku është bazuar auditimi janë Ligji Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); VKM Nr. 807, datë 16.11.2016 "Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore (i ndryshuar); Udhëzim Nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit". **Ndikimi/Efekti** Regjistrimi i veprimeve kontabël në ditarin e bankës jane kryer sipas planit kontabël dhe udhëzimeve përkatëse **Shkaku;** Rregjistrimi dhe kontabilizimi i veprimeve është kryer i rregullt në ditar, shuma e likujdimeve të urdhër - shpenzimeve është e njëjtë me shumën e pasqyruar në ditarin e bankës.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I ulët
Konkluzioni	Nga ana e personave përgjegjës është bërë një punë e mirë për të kryer regjistrimet kontable duke respektuar aktet ligjore në fuqi.
Rekomandimi	S'ka
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar
Statusi i rekomandimit	Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve

Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit: Në përfundim të auditimit të sistemit të pagesave vlerësojmë se nga ana e personave përgjegjës njihen dhe zbatohen aktet ligjore në fushën e kontabilitetit, në të gjitha urdhër shpenzimet ishin të bashkëlidhura dokumentat justifikues, urdhër shpenzimet ishin të firmosura si nga titullari i institucionit, shefja e sektorit të financës dhe thesari.

IV.6 Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Fushat të cilat u morën në konsideratë gjatë auditimit:

- Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, zbatimi i udhëzimeve të Ministrisë së Financave për plotësimin e pasqyrave financiare.

- Mbajtja dhe regjistrimi i dokumenteve financiare në librat e kontabilitetit; ditar banke, arke, magazine, etj.
- Pasqyrimi në bilanc i të drejtave dhe detyrimeve.
- Pasqyrimi i inventareve të aktiveve dhe rakordimi i tyre midis inventarizimit fizik dhe gjendjes kontabël të këtyre aktiveve.
- Përllogaritja e normës së amortizimit sipas llogarive përkatëse të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

Aktivet e qëndrushme të trupëzuara ishin pasqyruar saktë në ditarin e bankës dhe atë të shpenzimeve sipas llogarive përkatëse si dhe në bilancin e viteve ushtrimore.

Aktivet Afatgjata vlerësuar me kosto historike.

Llogaritë	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Vit 2021
212 "Ndërtime dhe konstruksione"	6,527,361	6,527,361	6,527,361	6,527,361
214 "Istalime teknike, mak., pajisje.	4,000,181	4,000,181	4,000,181	4,000,181
215 "Mjete transporti"	14,300,000	0	0	0
218 "Iventar ekonomik"	2,977,505	2,977,505	2,977,505	2,977,505
	27,805,047	13,505,047	13,505,047	13,505,047

Llog. 212 "Ndërtime dhe konstruksione".

Ndërtesa ku ushtron veprimtarinë IIPP (në rrugën "George Ë. Bush, Vila 2-katëshe përballë Parlamentit) sipas llogarisë 212, në fund të vitit 2021 rezulton në kontabilitet në vlerën 6.527.361 lekë. Kjo ndërtesë është një godinë 90-vjeçare dhe si pasojë e lëkundjeve të tërmetit, janë verifikuar disa çarje dhe plasaritje të konsiderueshme të mureve të brendshme dhe të jashtme të ndërtesës si dhe shkëputje të catisë në një pjesë të saj. Këto dëmtime janë konstatuar nga vlerësimi paraprak i situatës pas tërmetit të parë të muajit Shtator 2019, vlerësim i kryer nga z. Armando Ormeni, përfaqësues i Ministrisë së Kulturës. Më datën 17.10.2019 me shkresën nr. 2108/1 prot., ardhur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" është kërkuar rivlerësimi i situatës dhe përgatitja e preventivit për ndërhyrje emergjente të këtij objekti monument kulture i kategorisë së dytë.

Ndërkohë një muaj më vonë, nga tërmeti i datës 26.11.2019 me magnitudë 5.8 të shkallës Rihter dhe intensiet prej 7.5 ballë që goditi Shqipërinë, godina e IIPP-së e ndodhur në Rr. "George Ë. Bush" Vila 2- katëshe përballë Parlamentit, ka pësuar dëmtime të mëtejshme kryesisht në çatinë e saj.

Këto dëmtime të godinës janë konstatuar me anë të Akt – Konstatimit të datës 06.12.2019 "Mbi verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara nga tërmeti", hartuar nga grupi i inspektimit të Ministrisë së Infrastukturës dhe Energjisë (Instituti i Ndërtimit) të përbërë nga z. Agron Hysenlliu, dhe z. Edmond Drezi,

Pas ekspertizës, ky grup inspektimi e ka cilësuar godinën të pabanueshme dhe është vendosur të pezullohet aktiviteti i punës së IIPP-së deri në riparimin e dëmtimeve të mureve dhe çatisë së saj.

IIPP-ja për zgjidhjen e këtij problemi, i është drejtuar me disa kërkesa institucioneve shtetërore përkatëse. Konkretisht me shkresën nr. 863 prot., datë 17.12.2019 "Kërkesë për pajisje me zyra deri në riparim të godinës" drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kujdesit Social nga IIPP është kërkuar pajisja me zyra për të vijuar punën si institucion ndërsa me shkresën nr. 861 prot datë 17.12.2019 "Kërkesë për riparim të dëmeve në godinën e IIPP-së" drejtuar Ministrisë së Kulturës Tiranë (për dijeni Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës) dhe shkresës nr. 862 prot., datë 17.12.2019 drejtuar Ministrisë së Brendshme, është kërkuar të vijohet me procedurat e nevojshme për të riparimin e demtimeve te godinës në mënyrë që të rikthehet në normalitet puna e institucionit.

Ndërkohë, bazuar në urdhërin e IIPP-së nr. 855 prot., datë 16.12.2019 është ngritur grupi i punës si dhe është mbajtur proçes-verbali "Mbi studimin e tregut për llogaritjen e fondit limit për procedurën "Marrje ambjenti me qera për zyrat e IIPP-së". Me kontraten e qirasë nr. 7738 rep, nr. 1409 kol datë 26.12.2019, pala qiradhënëse (Z. Grigor Lengo) i jep me qera palës qiramarrëse (Institutit te Integrimit ish të Përndjekurve Politike) pasuri të paluajtshme me nr. pasurie 3/109+1-13 në zk 8270 vol 86 fq 191 me sip 112 m² dhe apartament me nr pasurie. 3/109+1-14 në zk 8270 vol 86, faqe 193 me sip 164 m² të ndodhur në Rrugën "Nikolla Tupe", ambjent i bashkuar nga ana funksionale për t'u përdorur nga pala qiramarëse per vijimin e aktivitetit.

Gjithashtu nga ana e IIPP me shkresën nr. 488 prot., datë 08.10.2021 "Kërkesë për riparim të dëmeve në godinën e IIPP-së" drejtuar Ministrisë së Kulturës dhe shkresës nr. 487 prot., datë 08.10.2021 drejtuar Ministrisë së Shtetit për Rindërtim, është rikërkuar sërish që të vijohet me procedurat e nevojshme për të riparimin e dëmtimeve të godinës në mënyrë që të rikthehet në normalitet puna e institucionit.

Më datën 15.12.2021 në takimin e zhvilluar ne ambjentet aktuale të IIPP-së në Rrugën "Nikolla Tupe", midis përfaqësuesve te IIPP-së, përfaqësuesve nga UNOPS dhe Arkitekteve të Studios Atelier 4, u prezantuan dy projekte për rikonstruksionin e godinës ku në perfundim u dakortësua per projektin më të përshtatshëm. Nga komunikimi në mënyrë elektronike nga përfaqësuesit e IIPP për sa më sipër rezulton se punimet për restaurimin e ndërtesës se Institutit te Integrimit ish të Përndjekurëve Politikë janë prokuruar nga UNOPS dhe pas përfundimit të procedurës së prokurimit, në muajin Prill 2022 pritet të fillojë puna për rikonstruksionin e saj.

Llogaria 215 "Mjete transporti".

Llogaria 215 "Mjete transporti" në fund të vitit 2018 rezulton në vlerën 14,300,000 dhe perfaqësohet nga dy automjete.

Në vitin 2019 dhe në vazhdim llogaria 215 "Mjete transporti" rezulton në vlerën zero për arsye se gjatë vitit 2019 të dyja automjetet janë nxjerrë jashtë përdorimit. Kjo për faktin se një automjet ka qenë jashtë funksionit, kurse automjeti tjeter tip "Daimler Chrysler" Mercedes Benz) me targë AA375 RE është djegur (ka marë flakë) në rrugën "Nikolla Tupe" referuar vërtetimit të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr. 4519 prot., datë 30.04.2019.

Nisur nga fakti i nxjerjes jashtë përdorimit të dy automjeteve, institucioni i IIPP për nevoja të zhvillimit normal të aktivitetit, me shkresën nr. 229 datë 03.04.2019 ka kërkuar pranë Ministrisë së

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale paisjen përkohësisht me një automjet deri në zgjidhjen e kësaj situate. Në përgjigje të kërkesës së bërë nga IIPP, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 1796/1 prot., datë 18.04.2019, sqaron se nuk ka asnjë automjet të lirë për ta vendosur në dispozicion të institucionit. Mbas përgjigjes së marë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucioni ka filluar procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për marjen me qera të një automjeti për nevojat e aktivitetit.

Gjaë auditimit të ushtruar në IIPP rezultoi se për periudhën 2019, 2020, 2021 nga institucioni janë kryer procedurat për marrjen me qera të automjetit dhe konkretisht:

Për vitin 2019 bazuar në urdhër shpenzimin nr. 119, datë 24.05.2019, marrje automjeti me qira në vlerë 466,800 lekë.

Për vitin 2020 bazuar në urdhër shpenzimim nr. 49, datë 10.03.2020, marje automjeti me qira në vlerë 936,000 lekë.

Për vitin 2020 bazuar në urdhër shpenzimi nr. 83, datë 26.03.2021, marje automjeti me qira në vlerë 936,000 lekë.

Në total vlera e shpenzuar për dy vjetë e gjysëm për marjen e automjetit me qira për nevojat e institucionit rezulton 2,338,000 lekë.

Duke analizuar këtë fakt theksojmë se këto shpenzime të bëra nga institucioni për marjen me qera të automjetit vërtet përmbushin objektivat e veprimtarisë në njësinë publike por nisur nga efektiviteti, eficenca dhe ekonomiciteti me këtë vlerë prej **2,338,000** lekë të shpenzuar për marjen me qera nga ky institucion mund të ishte blerë një automjet i ri i cili do të ishte si aset i institucionit dhe do të përdorej për një kohë shumë të gjatë duke i kursyer buxhetit të shtetit shumat e shpenzuara për marjen me qera në vitet në vazhdim.

Konkluzion; *Në përpjekje për të minimizuar shpenzimet, auditi vlerëson që institucioni të argumentojë nevojat për automjet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale. Kjo gjë do të ulte shpenzimet e bëra ndër vite për këtë shërbim shërbim që prokurohet cdo vit për automjetin me qera. Në PBA-në e vitit 2022 të planifikohen dhe të argumentohen nevojat për prokurimin e një automjeti që të përmbushë objektivat dhe të uli kostot.*

Si përfundim rekomandojmë*; Nga ana e institucionit në vazhdim gjatë hartimit të projekt buxhetit të pasqyrohet në kërkesat buxhetore nevoja për një automjet i cili do i shërbejë institucionit për të përmbushin objektivat e veprimtarisë.*

Titulli i gjetjes: Pasqyrimi i inventareve të aktiveve dhe rakordimi midis inventarit fizik dhe gjendjes kontable të këtyre aktiveve

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Sektori i Financës
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues

Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Udhëzimi nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. VKM nr. 561 datë 27.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Urdhër shpenzimi nr. 194, datë 26.05.2021 Objekti i shpenzimit; Blerje karburanti, 4500 litra në vlerë 670, 500 lekë Gjatë auditimit u konstatua se automjeti që është marrë me qira që prej muajit Maj 2021 furnizohej me karburant me Kartën Gold (tollon elektronik) dhe jo me kartë të personalizuar ku të pasqyrohet targa e makinës dhe institucioni. Ky veprim bie në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 561 prot., datë 29.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 1. Karburanti është bërë hyrje me fletë hyrje nr. 1 datë 25.05.2020, sasia 4.500 litra dhe dalje me fletë dalje nr. 1, date 25.05.2021 me sasi 4.500 litra. Gjithashtu gjatë auditimit u konstatua se nga magazinierja e këtij institucioni (që është komanduar me urdhër të drejtorit) e gjithë kjo sasi karburanti prej 4500 litra i bëhej dalje shoferit njëherësh dhe jo për çdo rast furnizimi të justifikuar me udhëtimet e kryera për nevoja të institucionit sipas urdhërave të drejtuesit të tij. Duke ju referuar sistemit në mënyrë elektronike dalja e karburantit nuk bëhej dalje sa herë furnizohej ky automjet, por një herë në muaj. Po kështu u konstatua se nuk kryheshin rakordime për karburantin e berë dalje ndërmjet shefes së financës dhe magazineres që është caktuar me urdhër të brendshëm. Inventari i aktivit është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë e gjendjes kontabele dhe asaj fizike në një periudhë te caktuar. **Kriteri:** Udhëzimi nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. VKM nr. 561 datë 27.07.2016 "Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 74. **Ndikimi/Efekti:** Referuar mënyrës së shpërndarjes dhe dokumentimit

	të karburantit (Kartes Gold), nuk justifikohet përdorimi i tij vetëm për nevoja të institucionit si dhe i lihet shkas abuzimit dhe shpërdorimit të tij. **Shkaku:** Mos njohja e bazës ligjore nga ana e Sektorit te Financës.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Mos funksionimi i kontrollit të brendshëm dhe mungesa e gjurmës së auditit me qëllim menaxhimin me sa më efektivitet të lëvizjes dhe përdorimit të karburantit i cili duhet të kryhet në bazë te autorizimit te leshuar nga titullari i institucionit ku të jetë përcaktuar dhe aryeja e lëvizjes së automjetit.
Rekomandimi	**1-** Nga Nëpunësi Autorizues i këtij instiucioni të ndërpritet menjëherë furnizimi i karburantit me Kartën Gold dhe për çdo furnizim të përdoret Karta e Personalizuar. **2-** Dalja e karburantit të bëhet me autorizim nga Nëpunësi Autorizues ku të pasqyrohet arsyeja e lëvizjes së automjetit për harxhimin e karburantit, dhe për çdo rast udhëtimi në bazë të harxhimit të karburantit sipas kilometrave të pritet fletë dalja. **3-** Gjithashtu nga sektori i financës në fund të çdo muaji të kryhet rakordimi midis sektorit të financës dhe magazinës dhe ne fund te vitit te kryhet inventari fizik dhe kontabel i karburantit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Titulli i gjetjes: Në vazhdim.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Sektori i finances
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Udhëzimi nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Urdhëri i Ministrisë së Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit ekonomik buxhetor", si dhe

	nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit).
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Për verifikimin fizik të aktiveve në mënyrë rastësore u përzgjodh inventarizimi i vitit 2021, llogaritë e aktiveve materiale dhe konkretisht, llogaria 214 "Instalime teknike, pajisje dhe vegla pune" dhe llogaria 218 "Inventar ekonomik". Nga verifikimi fizik i aktiveve në ish Godinën e Institutit të Integrimit ish të Përndjekurve Politike, rezultoi se në zyrat e kësaj godine kishte aktive si: kondicionerë, tavolina, dollapë, etj, një pjesë e mirë e të cilave ishin në gjendje të mirë funksionale. Duke pasur parasysh faktin që kjo godinë do ti nënshtrohet rikonstruksionit total, lënia e këtyre aktiveve nën veprimin e agjenteve atmosferike, rritë mundësinë e dëmtimit dhe nxjerjes së tyre jashtë funksionit. Kjo për faktin se këto aktive janë në ngarkim të punonjësve të këtij institucioni. **Kriteri:** Udhëzimi nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Urdhëri i Ministrisë së Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit ekonomik buxhetor", si dhe Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit). **Ndikimi/Efekti:** Për aktivet që janë në gjendje të mirë funksionale, të meren masa nga institucioni për largimin e tyre para se të fillojë rikonstruksioni i godinës. **Shkaku:** Asetet kanë dy vjet e gjysëm që janë në këto ambiente dhe instucioni duhet të kishin marrë masat e duhura.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I ulët
Konkluzioni	Institucioni ka për detyrë të marrë masa të nevojshme për mbrojtjen, ruajtjen, qarkullimin e aktiveve me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keq përdorimi. Çdo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve që ka në përdorim dhe në inventar.
Rekomandimi	Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa të menjëhershme për aktivet (kondicionere, tavolina, dollapë etj) të cilat ndodhen në Godinën e Institutit të Integrimit ish të Përndjekurve Politike, të sistemohen në një ambjent të veçantë për t'i mbrojtur ato nga dëmtimi, keqpërdorimi apo humbja e tyre.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Titulli i gjetjes: Pasqyrimi i inventarve sipas llogarive përkatëse

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Komisioni i blerjeve të vogla
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit buxhetor". Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6. Udhëzimi nr. 8 datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Udhëzimi e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Gjatë auditimit, nga inventari kontabël u konstatua se nuk ka një ndarje të mirëfilltë të Aktiveve Afatgjata materiale ndërmjet llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe llogarisë 218 "Inventar ekonomik", bazuar në Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit buxhetor", si dhe nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit). Gjithashtu ky veprim ka ndikuar dhe në përllogaritjen e normës së amortizimit, (referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, amortizimi i aktiveve afatgjata bëhet mbi bazë grupimi). **Kriteri:** Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit buxhetor", si dhe Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit). **Ndikimi/Efekti:** Klasifikimi jo i saktë i Aktiveve Afatgjata Materiale sipas llogarive ndikon në përcaktimin e jetëgjatësisë së këtyre aktiveve për shkak se vlera e amortizimit është e ndryshme për cdo llogari. **Shkaku:** Mos zbatimi korrekt i legjislacionit përkatës dhe akteve nënligjore nga ana e Nëpunësit Zbatues të institucionit ka bërë të mundur që këto aktive mos pasqyrohen në llogaritë përkatëse sipas Urdhërit të Ministrisë së Financave "Për miratimin e manualit të klasifikimit ekonomik buxhetor."

Vlerësimi i nivelit të riskut	I Ulët
Konkluzioni	Vendosja gabim e klasifikimit buxhetor ndikon në një pasqyrim jo të saktë të aktiveve të institucionit. Evidentimi dhe klasifikimi i drejtë i aktiveve sipas llogarive perkatëse bën të mundur menaxhimin sa më të mirë si dhe përcaktimin e saktë të vlerës reale kontabile te tyre.
Rekomandimi	Nga shefja e financës se këtij institucioni para mbylljes së bilancit të vitit 2022 të sistemohen veprimet e llogarive 214 dhe 218, shumat të pasqyrohen në bilancin e fundvitit të klasifikuar sipas llogarive përkatëse bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit ekonomik buxhetor", si dhe nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit). Veprimet rregulluese të jenë pjesë e pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe në relacionin shoqërues të jepen shpjegimet për veprimet e ndërmara nga struktura përgjegjëse për financën (Nëpunësi Zbatues).
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Në përfundim të auditimit vlerësojmë se sistemi i kontabilitetit ka funksionuar mirë në drejtim të kontrollit të brendshëm përveç rasteve të trajtuara më sipër që lidhen me menaxhimin e aktiveve që ndodheshin në godinën që do të kryhej dhe rikonstruksioni.
Po kështu nuk ka funksionuar mirë kontrolli i brendshëm për sa i përket ndarjet e aktiveve sipas llogarive përkatëse bazuar në Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit).
Gjithashtu mjedisi i kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar mirë në drejtim të evidentimit dhe dokumentimit të përdorimit të karburantit për automjetin e marrë me qera nga institucioni (përdorimi i kartës gold dhe jo asaj të personalizuar ku pasqyrohet targa e automjetit dhe institucioni).

IV.7 Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore.
Objektivi i auditimit:
Vlerësimi nëse të ardhurat dytësore janë krijuar dhe janë përdorur me efektivitet, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:
- Hartimi i evidencave për fondet e krijuara nga veprimtaria dhe raportimi i realizimit të të ardhurave dytësore në organin qendror.

- Shpërndarja e të ardhurave të krijuara ndaj shoqatave të të përndjekurve politikë dhe individëve bazuar në kritere të përcaktuara. Verifikimi i dokumentacionit vërtetues të paraqitur nga shoqatat/individët të cilat kanë përfituar të ardhura.
-Mbledhja e të ardhurave dytësore nga ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore në zbatim të akteve ligjore në fuqi.
- Monitorimi i projekteve të përfituara nga shoqatat që kanë përfituar të ardhura nga IIPP-ja.

Hartimi i evidencave për fondet e krijuara nga veprimtaria dhe raportimi i realizimit të të ardhurave dytësore në organin qendror.

Nga ana e përgjegjësit të sektorit të financës dhe shërbimeve bëhej rakordimi me degën e thesarit dhe hartoheshin evidenca për të cilat vihej në dijeni Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- Shpërndarja e të ardhurave të krijuara ndaj shoqatave të të përndjekurve politikë dhe individëve bazuar në kritere të përcaktuara. Verifikimi i dokumentacionit vërtetues të paraqitur nga shoqatat/individët të cilat kanë përfituar të ardhura.

Bazuar nga evidencat vënë në dispozicion nga sektori i financës dhe shërbimeve, u hartua tabela e mëposhtme e cila i referohet të ardhurave të realizuara për periudhën 2018 – 2021, si dhe përdorimi i tyre. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 392 datë 12.08.1999 për "Administrimin e fondit të veçantë monetar", 50 % e fondit të krijuar shkon për të ndihmuar, ekonomikisht dhe materialisht, familjet e përndjekura, ndërsa 50 % tjetër shkon për financimin e shoqatave të ish të përndjekurve politikë.

Viti	Të trashëguar a nga viti i mëparshëm	Të ardhura viti aktual	Totali i të ardhurave	Përdorur për shoqatat/ në vlerë.	Në %	Përdorur për ndihma ekonomike, riparime, sponsorizime në vlerë	Në %	Totali i përdorur në vlerë.	Trashëgohen në vitin pasardhës
2018	38,300,521	65,146,619	103,447,140	15,460,000	15.1 %	17,922,500	17.3 %	33,382,500	73,063,140
2019	73,063,140	57,466,636	130,529,776	36,750,000	28.1 %	39,377,900	30.1 %	76,127,900	57,389,376
2020	57,389,376	59,464,741	116,854,117	34,130,000	29.2 %	39,377,900	30.1 %	77,534,500	42,304,117
2021	42,304,117	34,450,809	76,754,926	37,330,000	48.6 %	38,835,000	50.5 %	76,165,000	3,589,926

Nga tabela e mësipërme vërehet re, se nga ana e përfituesve të këtyre fondeve, shoqatave dhe fondit të përdorur për ndihmë ekonomike, në asnjë rast nuk është tejkaluar limiti i përcaktuar në Vendimin Nr. 392, datë 12.08.1999 "Për Administrimin e Fondit të Vecantë Monetar", të krijuar sipas Ligjit Nr.7598, datë 01.09.1992 "Për ish të Dënuarit dhe ish të përndjekurit politikë".

-Mbledhja e të ardhurave dytësore nga ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore në zbatim të akteve ligjore në fuqi.
Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve në bazë të Ligjit Nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish të dënuarit e të përndjekurit politikë" krahas fondit të buxhetit të shtetit, arkëton të ardhura të cilat mblidhen nga institucionet shtetërore jobuxhetore në masën 1% mbi fondin e tyre të pagave. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 392 datë 12.08.1999 për "Administrimin e fondit të veçantë monetar" ky fond ndihmon institucionin në trajtimin me ndihmë ekonomike personat ish të përndjekur politikë, të cilët janë në gjendje të vështirë ekonomiko-

financiare, gjithashtu sponsorizon shoqata dhe individë ish të përndjekur politikë për aktivitete të ndryshme përkujtimore, për rehabilitimin dhe lartësimin e vlerave morale dhe shoqërore të ish të përndjekurve politike. Kalimi i këtij fondi është shumë i rëndësishëm në mirëfunksionimin e sektorit social në ndihmë të integrimit të kësaj shtrese.

Titulli i gjetjes: Mos derdhja e detyrimit ligjor nga ndërmarrjet shtetërore jopublike.

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Instituti i Integrimit të ish të Përndjekurve
Subjektet e interesuara nga gjetja	Sektori i Cështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar".
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Nga auditimi i krijimit të fondit të vecantë, u konstatua se jo të gjithë ndërmarjet shtetërore jobuxhetore kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën prej 1% mbi fondin e pagave. Ndërmarjet shtetërore jobuxhetore, janë; 1- Albpetrol, 2- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm, 3- Oshee, për vitin 2021 nuk ka derdhur 4- Albcontrol/ për vitin 2020 (6 muaj), për vitin 2021 nuk kanë derdhur 5- Enti Kombëtar i Banesave, vetëm Tirana, asnjë drejtori rajonale nuk ka derdhur 6- Ujësjellës Kanalizime, vetëm Tirana, asnjë drejtori rajonale nuk ka derdhur 7- Operatori i Sistemit të Transmetimit, 8- Autoritetet Portuale/ Durrësi ka derdhur, Vlora për vitet 28-20, për vitin 2021 jo, asnjë qytet tjetër. 9- Posta Shqiptare/asnjë drejtori rajonale nuk ka derdhur, vetëm Drejtoria e Përgjithshme ka derdhur. Ky veprim është në kundërshtim me shkronjën "b" të nenit 1 të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar". Për sa më sipër Instituti i të Përndjekurve Politikë e ka ndjekur me vëmendje këtë cështje, ku për gjithë periudhën 2018 – 2021, ka dërguar shkresa të vazhdueshme për trajtimin e këtij rasti nga ndërmarjet shtetërore jobuxhetore të përmendura më sipër me përparësi. Institucioni ka dërguar shkresë me nr. 485 prot, datë

	28.09.2017, Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky i fundit i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1014/1 prot., datë 11.10.2017 duke bashkëlidhur edhe shkresën me nr. 1014/2 prot., datë 11.10.2017 që KLSH-ja ju ka dërguar 12 institucioneve për përmbushjen dhe zbatimin e Ligjit Nr.7598, datë 01.09.1992 "Për ish të Dënuarit dhe ish të përndjekurit politikë". Po kështu institucioni i ka dërguar shkresë me nr. 610 prot, datë 26.09.2018 Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Instituti i të Përndjekurve Politikë ka dërguar shkresë me nr. 698 prot, datë 01.11.2018 Kontrolli të Lartë të Shtetit, KLSH-ja, i ka dërguar shkresë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor për përmbushjen e detyrimit ligjor, fond i vecantë për llogari të IIPP. Për vitin 2020 i është dërguar sërish shkresë Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 322 prot., datë 23.07.2020. **Kriteri:** Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", neni 1, shkronja b. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar". **Ndikimi/Efekti:** Ky fond ndihmon IIPP në trajtimin me ndihmë ekonomike për personat ish të përndjekur politikë, të cilët janë në gjendje të vështirë ekonomiko-financiare, gjithashtu, sponsorizon shoqata dhe individë ish të përndjekur politikë për aktivitete të ndryshme përkujtimore, për rehabilitimin dhe lartësimin e vlerave morale dhe shoqërore të ish të përndjekurve politike. Kalimi i këtij fondi është shumë i rëndësishëm në mire funksionimin e sektorit social në ndihmë të integrimit të kësaj shtrese. **Shkaku:** Ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre ligjor.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Nga ana e institucionit është bërë një punë e mirë në adresimin e këtij rasti në organet kompetente, si KLSH, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Rekomandimi	Nga ana e institucionit të ndiqet në vazhdimësi procesi i mbledhjes së të ardhurave nga ndërmarrjet jobuxhetore si pasojë e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit

	politikë", neni 1, shkronja b.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Titulli i gjetjes: Monitorimi i projekteve gjatë gjithë fazës së projektit

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Institutit të Integrimit të të përndjekurve Politikë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Grupi i Punës/monitorimit Sektori i Cështjeve Sociale dhe Koordinimit të Projekteve
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji Nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë". Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar". Rregullore e Funksionimit të Komisionit të Trajtimit të Ndihmave Ekonomike.
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Pranë Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë funksionon komisioni i trajtimit të shpërndarjes së fondeve që mblidhen në zbatim të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", neni 1, shkronja b. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni janë të mirëpërcaktuara në rregulloren e funksionimit të komisionit të trajtimit të ndihmave ekonomike të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Ky komision është i përbërë nga kryetari dhe 4 anëtarë. Kërkesat për ndihmat ekonomike por edhe projektet nga shoqatat bëhen nëpërmjet kërkesave pranë sektorit të cështjeve sociale dhe koordinimit të projekteve. Në këtë rregullore janë përcaktuar edhe kriteret e përgjithshme të përdorimit të këtyre fondeve. Bazuar në teknikat e auditimit u përzgjodhën në mënyrë rastësore mbi 25 % të rasteve të miratimit të projekteve për vitin 2021. - U përzgjodh projekti i hartuar nga Shoqata për Projektet e Asistencës së ish të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, me titull projekti "Organizim kurse gjuhë e huaj" me vlerë projekti 5.400.000 lekë, kohëzgjatja e projektit 6 muaj. Ky projekt ka pasur si qëllim organizimin e kursit të gjuhës së huaj për 50 ish të përndjekur politikë për prefekturën e Shkodrës. Projekti ka emrat e personave që do trajnohen si dhe numrin e kartës së identitetit. Kursi është zhvilluar në datën 10.02.2021 dhe ka përfunduar më datën

	10.08.2021.Është mbajtur procesverbali nga ana e grupit të monitorimit me nr x prot., datë 23.07.2021. -U përzgjodh projekti i hartuar nga Shoqata e Integrimit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politik të Shqipërisë, me titull projekti "Organizim kurse të ndryshme profesionale, gjuhë të huaj, anglisht, frëngjisht, kuzhinier, marangoz, mekanikë dhe parukeri" me vlerë projekti 8.400.000 lekë, kohëzgjatja e projektit 6 muaj. Ky projekt ka pasur si qëllim organizimin e kurseve të ndryshme për 50 të rinj e të reja. Ky projekt nuk ka emrat e personave që do trajnohen si dhe numrin e kartës së identitetit. Kursi është zhvilluar nga muaji shkurt 2021 deri më 28.06.2021. Është mbajtur procesverbali nga ana e grupit të monitorimit me nr extra prot., datë 15.07.2021. Nga vlerësimi i projekteve të lartëpërmendura konstatohet se monitorimi i projektit, kryhet kur ka përfunduar i gjithë projekti. Duke qënë që IIPP-ja ka një rol shumë të rëndësishëm në këtë proces, duhen shtuar filtra kontrolli mbi monitorimin e projekteve, c'ka do të thotë që monitorimi i projektit të shtrihet në të gjitha fazat e tij dhe jo vetëm në fund të projektit. Edhe pse nga grupet e punës është bërë një punë e kënaqshme në momentin që kanë shkuar te shoqatat duke parë gjithë dokumentacionin e nevojshëm, mbajtja e procesverbalit përkatës, administrimi i faturave me tvsh, sërish gjetja e auditit konsiston te mbikqyrja herë pas here e projektit në tërësi si dhe dokumentimi i gjithë projektit me cdo dokument justifikues që justifikon shpenzimin e kryer dhe jo të mbetemi vetëm te marrja e faturave me tvsh. Pjesë e dosjes së monitorimit duhet të jenë; emrat e personave që janë trajnuar dhe për cfarë profili janë trajnuar, ndarja e grupeve sipas kursit të kryer, afati kur duhet kryhej ky kurs për cdo grup, kopje të certifikatave në përfundim të kursit për të gjithë pjesmarrësit sipas kurseve të kryera. Në asnjë rast nuk u konstatua që shoqatat të kenë hartuar një relacion përmbledhës që vënë në dijeni IIPP mbi mbarëvajtjen e projektit, ecurinë e tij, listën e personave përfitues të firmosur prej tyre, certifikatat e pjesmarrjes. Certifikat e pjesëmarrësve sidomos kur ofrohen kurse profesionale medoemos duhet të kërkohen nga ana e grupeve të punës dhe të bëhen pjesë e dosjes, kjo gjë i jep siguri institucionit se fondet e dhëna nga fondi i vecantë përdoren për qëllimin që janë dhënë. Po kështu që në momentin e miratimit të këtyre projekteve duhet ti kushtohet një vëmendje e vecantë edhe përzgjedhjes së subjekteve ku do të kryhet kursi, që këto subjekte të

	jenë të miratuara nga organet kompetente dhe certifikatat me anë të të cilat pajisen personat të jenë komfort të gjithë akteve ligjore në fuqi. **Kriteri:** Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", neni 1, shkronja b. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar". **Ndikimi/Efekti:** Monitorimi i vazhdueshëm i projekteve i jep siguri institucionit se fondet e dhëna nga fondi i vecantë përdoren për qëllimin që janë dhënë.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Duhen shtuar filtra kontrolli që dokumentimi i zbatimit të projekteve të kryhet i plotë.
Rekomandimi	Nga ana e institucionit ti kushtohet rëndësi monitorimit të projekteve, i cili duhet të shtrihet në të gjitha fazat e tij dhe jo vetëm në fund të projektit. Dosja e monitorimit duhet të ketë gjithë dokumentacionin e nevojshëm si listën e pjesmarrësve në trajnim, axhendën e trajnimit, vendin ku kryhet trajnimi, kopje të certifikatave të trajnimit për cdo pjesëmarrës, me qëllim dhënien e sigurisë te titullari, që përdorimi i fondeve të dhëna nga fondi i vecantë janë përdorur me eficencë, efektivitet dhe ekonomi. **Afati:** Në vazhdimësi
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	*Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar*
Statusi i rekomandimit	*Për tu kompletuar mbas fazës së observacioneve*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Në përfundim të auditimit vlerësojmë se sistemi i të ardhurave dytësore ka funksionuar mirë në drejtim të kontrollit të brendshëm për dhënien e fondit të vecantë brenda normave të lejuara. Rëndësi të vecantë duhet ti kushtohet monitorimit të projekteve që nga trajnimi, te mbikqyrja herë pas here e projektit në tërësi si dhe dokumentimi i gjithë projektit me cdo dokument justifikues që justifikon shpenzimin e kryer. Duhen shtuar filtra kontrolli që dokumentimi i zbatimit të projekteve të kryhet i plotë.

V. Të tjera.
Probleme të ndryshme të konstatuara gjatë punës në terren.

Gjatë auditimit në terren nuk pati gjetje të tjera.

VI.Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme, ndarja e detyrave, përgjegjësive dhe linjat e raportimit.

Zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet komponenteve të ndërlidhur me njëri tjetrin:

Titulli i gjetjes: Sistemi i kontrollit të brendshëm

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Institutit të Integrimit të të përndjekurve Politikë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues Të gjitha nivelet e menaxhimit
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 21. Rregullorja e brendshme e institucionit. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Përshkrimi i gjetjes	***Mjedisi i kontrollit***: Institucioni ka ushtruar veprimtarinë e tij në bazë të projekt rregullores aktuale të hartuar nga institucioni që në vitin 2015. Nga vlerësimi i projekt rregullores konstatohet se kjo regullore ka të përfshirë misionin, objektivat, detyrat e përgjegjësve të sektorëve, por kësaj rregullore duhet ti shtohen elemente dhe detyra të tjera. Po kështu, mungojnë detyrat e personelit mbështetës, si arkiv/protokoll, mungojnë gjurma e hyrjes dhe daljes së dokumentave në institucion, mungojnë detyrat e nëpunësit të informacionit, detyrat e shofer/ korrier, sekretar si dhe detyrat e punonjës pastrimi. Për këtë, kjo projekt rregullore duhet të ndryshojë dhe më pas të dërgohet në organin qendror dhe të miratohet nga Ministri i MSHMS, në zbatim të Ligjit nr. 90/2012 "Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore". Struktura e institucionit ishte e qartë dhe për cdo sektor ka një përgjegjës sektori që mbikqyrte punën e specialistëve. Ky institucion është pjesë e shërbimit civil dhe marrëdhënia e punës për të gjithë punonjësit është e rregulluar nga Departamenti i Administratës Publike. Emërimet dhe largimet në këtë institucion, kryheshin nëpërmjet procedurave të konkurimit të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike. Nga ana e institucionit për periudhën e audituar janë kryer vlerësimet vjetore të performancës për gjithë personelin, dhe janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion si janë të përcaktuar në strukturën e institucionit. Punonjësit ishin në kontakt të vazhdueshëm me kalendarin e trajnimeve nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për të përvetësuar njohuritë sipas sektorëve dhe fushës ku ushtrojnë detyrat dhe funksionet e tyre. Një pjesë e stafit është trajnuar nga ICMP-ja (Organizatë Ndërkombëtare për Gjetjen dhe

	Identifikimin e të Zhdukurve) në vitin 2018 në Bosnjë. ***Menaxhimi i riskut:*** Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë ka hartuar rregjistrin e riskut në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ky komponent i kontrollit të brendshëm është mjaft i rëndësishëm në fushën e menaxhimit të aktiveve por jo vetëm për aktivet, pasi do të vlerësonte risqet e mundshme si dhe marrjen e masave të duhura nga ana e menaxhimit bazuar kjo në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat koordinatorit të menaxhimit financiar të kontrollit dhe koordinatorit të riskut të njësisë publike". Nisur nga kjo theksojmë se duhen planifikuar risqet që mund të cënojnë keq përdorimet e aktiveve, mosplanifikimi i mirëmbajtjes së aktiveve, ruajtja nga zjarret etj, të cilët mund të cënojnë institucionin në realizimin e objektivave të tij. Një gjetje e tillë është edhe te sistemi i kontabilitetit, ku janë pasqyruar aktivet të cilat duhet të zhvendosen nga ndërtesa e vjetër e IIPP-së mbas rastit të shkaktuar nga tërmeti në vitin 2019. Ky rregjistër është i hartuar për të gjithë sektorët sipas strukturës së institucionit. ***Aktivitetet e kontrollit:*** Nga auditimi rezultoi se kanë funksionuar si duhet kontrollet e brendshme lidhur me sistemin e burimeve njerëzore, sistemin e pagesave, ku cdo punonjës është i njohur me kontratën e punës. Punonjësit janë pjesë e shërbimit civil si të tillë të gjithë punonjësit kanë statusin e nënpunësit civil. Cdo urdhër shpenzimi kryhej vetëm me dokumentacion justifikues, vërtetues. Të gjitha urdhër–shpenzimet, firmoseshin nga drejtori i përgjithshëm, përgjegjësi i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse dhe nëpunësi i thesarit, duke respektuar në këtë mënyrë rregullin e firmës së dyfishtë. Komponentët e kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar siç duhet sidomos në sistemin e monitorimit të projekteve ku monitorimi është kryer në fund të projektit, dhe jo te mbikëqyrja herë pas here e projektit në tërësi, si dhe dokumentimi i gjithë projektit me cdo dokument justifikues që justifikon shpenzimin e kryer dhe jo të mbetemi vetëm te marrja e faturave me tvsh. Për këtë duhen shtuar filtra kontrolli që dokumentimi i zbatimit të projekteve të kryhet i plotë. Te sistemi i prokurimeve me vlerë të vogël u konstatua se në 5 raste nuk ishte kryer përllogaritja e fondit limit përpara nxjerjes së urdhër prokurimit nga titullari i institucionit (nuk është dokumentuar ky proces në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për prokurimet). ***Informacioni dhe komunikimi:*** Ky komponent është kuptuar si shkëmbim i informacioneve ndërmjet punonjësve të të gjithë niveleve si horizontalisht dhe vertikalisht. Komunikimi midis sektorëve dhe titullarit bëhet me komunikim shkresor. Drejtori i institucionit informohej në mënyrë shkresore mbi veprimtarinë e

	cdo sektori. ***Monitorimi:*** Monitorimi është tëresia e proceseve të aktivitetit të njësisë e cila synon që aktivitetet e kontrollit të funksionojnë për qëllimin që ato janë ngritur. Titullari institucionit informohet vazhdimisht nga sektorët përkatës me anë të informacioneve, evidencave dhe raporteve të ndryshme. Institucioni kontrollohet nga Ministria e Shëndetësisës dhe Mbrojtjes Sociale dhe në raportet e dërguara janë lënë rekomandime për përmirësimin e punës në këtë njësi. Monitorimi ka qenë në nivelin e duhur dhe kjo jo vetëm në nivel titullari por dhe në nivelet e tjera si shef sektori, specialist, etj. Niveli i duhur i monitorimit ka garantuar qe punonjësit të zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet dhe aktivitetet e kontrollit te funksionojnë siç duhet. **Kriteri:** Ligji Nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 21. Projekt Rregullorja e brendshme e institucionit. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. **Ndikimi/Efekti:** Kontrollet e brendshme, duhen vlerësuar si një veprimtari e përditëshme dhe funksionale e të gjithë stafit, sipas përcaktimit të detyrave dhe ndarjeve të përgjegjësisë që evidentohen në kontratat e punës, përshkrimin e punës, regjistrin e riskut dhe jo vetëm. Cdo punonjës ishte i njohur me përshkrimin e punës, kontraten e punës.

VII. Rishikimi i cilësisë.

Angazhimi i auditimit është kryer në përputhje me standartet e parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Është kryer ndarja e detyrave nga përgjegjësi i grupit të auditimit për cdo specialist dhe deri në momentin e hartimit të projekt raportit të auditimit stabndartet dhe afatet kohore të angazhimit janë kryer në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të brendshëm.

VIII. Rekomandimet.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra nga grupi i auditimit, bazuar në germën "c" të nenit 6, dhe germën "e" të nenit 16, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin Publik", për arritjen e objektivave në Institutin e Integrimit të të Përndjekurve Politikë Tiranë, si dhe për të rritur efektivitetin në punën, funksionimin dhe drejtimin e këtij institucioni, janë lënë 9 rekomandime, 4 rekomandime në sistemin e kontabilitetit, 2 rekomandime në sistemin e prokurimeve me vlerë të vogël, 1 rekomandim te burimet njerëzore, 2 rekomandime te sistemi i të ardhurave dytësore.

IX. Falenderime.

Për plotësimin e misionit të auditimit, falenderojmë institucionin, për gadishmërinë e plotë që treguan për vënien në dispozicion të dokumentacionit, komunikimin dhe bashkëpunimin me njësinë audituese në realizimin e misionit të auditimit.

Gjithashtu, bazuar në nenin 12/d, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", "Plani i Veprimit" për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, të miratohet nga titullari i institucionit dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, jo më vonë se 20 ditë pune nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas formatit të sugjeruar nga ana jonë.

Në zbatim të pikës 4.1.13.3 "Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB" të MAB, duhet të caktoni një punonjës me përvojë që të evidentojë rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë vazhdimisht në MSHMS për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Së bashku me Planin e Veprimit, lutemi të dërgoni personin e caktuar dhe pikat e kontaktit të tij.

Ky Raport Përfundimtar hartohet në 3 kopje, 1 kopje i dorëzohet subjektit të audituar, një kopje lihet në protokoll dhe një kopje e mban Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Grupi i Auditit

Sonila Rreshka

Zogulla Koto

Formati Standard 10:
Model plan veprimi i plotësuar nga grupi i auditimit dhe subjekti i audituar.

Nr. i Rek	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar (Dakord/Jo Dakord)	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1	Nga ana e institucionit, në vazhdim gjatë hartimit të projekt buxhetit, të pasqyrohet në kërkesat buxhetore nevoja për një automjet, i cili do i shërbejë institucionit për të përmbushur objektivat e veprimtarisë.	I mesëm	faqja 22		Gjatë hartimit të projekt buxhetit	
2	2.1- Nga Nëpunësi Autorizues i këtij instiucioni të ndërpritet menjëherë furnizimi i karburantit me Kartën Gold dhe për çdo furnizim të përdoret Karta e Personalizuar. 2.2- Dalja e karburantit të bëhet me autorizim nga Nëpunësi Autorizues ku të pasqyrohet arsyeja e lëvizjes së automjetit për harxhimin e karburantit, dhe për çdo rast udhëtimi në bazë të harxhimit të karburantit sipas kilometrave të pritet flete dalja. 2.3- Gjithashtu nga sektori i financës në fund të çdo muaji të kryhet rakordimi midis sektorit të financës dhe magazinës dhe në fund të vitit të	I mesëm	faqja 22		Menjëherë dhe në vazhdimësi	

	kryhet inventari fizik dhe kontabël i karburantit.					
3	Nga Nëpunësi Autorizues të meren masa të menjëhershme qe aktivet (kondicionere, tavolina, dollapë etj) të cilat ndodhen në Godinën e Institutit të Integrimit ish të Përndjekurve Politike, të sistemohen në një ambjent të veçantë për t'i mbrojtur ato nga dëmtimi, keqpërdorimi apo humbja e tyre.	I Ulët	faqja 24		Menjëherë	
4	Nga shefja e financës se këtij institucioni para mbylljes së bilancit të vitit 2022 të sistemohen veprimet e llogarive 214 dhe 218, shumat të pasqyrohen në bilancin e fundvitit të klasifikuar sipas llogarive përkatëse bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Financave nr. 3575 prot., datë 29.05.2003 "Për miratimin e manualit të klasifikimit ekonomik buxhetor", si dhe Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik, publikuar në faqen e Ministrisë së Financave (Dega e Thesarit). Veprimet rregulluese të jenë pjesë e pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe në relacionin shoqërues të jepen shpjegimet për veprimet e ndërmara nga struktura përgjegjëse për financën (Nëpunësi Zbatues).	I Ulët	faqja 25		Në fund të vitit 2022	

5	Nga struktura përgjegjëse për prokurimin ose grupi i punës për çdo prokurim, në vazhdimësi të bëhet përllogaritja e vlerës së fondit limit bazuar në çmimet e tregut dhe në përfundim i gjithë dokumentacioni që lidhet me përllogaritjen e vlerës së kontratës të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit	I mesëm	faqja14		Menjëherë	
6	Në vazhdimësi nga ana e institucionit për çdo punim të kryer të hartohet paraprakisht një preventiv për llogaritjen e fondit limit si dhe specifikimet teknike me specialistë të fushës për të përcaktuar saktë vlerën e punimeve që do të kryhen.	I mesëm	faqja 15		Në vazhdimësi	
7	Nga ana e institucionit, të bashkëpunohet me përgjegjësit e sektorëve dhe të hartohet rregullorja e re, për cdo pozicion që është i miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 244, datë 1.11.2018 "Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Integrimit të të Përndjekurve Politikë. Pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm të dërgohet për miratim në organin qendror (MSHMS).	I mesëm	faqja11		Menjëherë	
8	Nga ana e institucionit të ndiqet në vazhdimësi procesi i mbledhjes së të ardhurave nga ndërmarrjet jobuxhetore si pasojë e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë", neni 1, shkronja b.	I mesëm	faqja 29		Në vazhdimësi	

9	Nga ana e institucionit ti kushtohet rëndësi monitorimit të projekteve, i cili duhet të shtrihet në të gjitha fazat e tij dhe jo vetëm në fund të projektit. Dosja e monitorimit të ketë gjithë dokumentacionin e nevojshëm si; listën e pjesmarrësve në trajnim, axhendën e trajnimit, vendin ku kryhet trajnimi, kopje të certifikatave të trajnimit për cdo pjesëmarrës, me qëllim dhënien e sigurisë te titullari, që përdorimi i fondeve të dhëna nga fondi i vecantë janë përdorur me eficencë, efektivitet dhe ekonomi.	I mesëm	faqja 31		Në vazhdimësi	

Grupi i auditit

Sonila Rreshka

Zogulla Koto

Për IIPP Tiranë

Bilal Kola – Drejtor i Përgjithshëm